



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
MK-68
Prishtinë, më 9 qershor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 9 QERSHOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Myfera Shinik.

Kryetarët e grupeve parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja, Petrit Hysaj, kurse nga NDI-ja, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryetari propozoi edhe dy (2) pika shtesë

1. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e vizitës në Spanjë dhe
2. Njoftimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e deputetëve – anëtarë të komisionet parlamentare.

Kryesia, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 qershor 2009,
2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me incidentin në Dhomën e Provave të Policisë së Kosovës të datës 25 prill 2009,
3. Shqyrtimi i propozimit për përbërjen, numrin dhe rindarjen e komisioneve parlamentare,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rishikimin funksional dhe nivelimin e pagave të KPM-së,
5. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Nexhat Daci për udhëtim zyrtar në SHBA,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Joformal të Grave Deputete, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci,
7. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projektligjit për KPMK- për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Iniciativës së qytetarëve të rrethinës së Hogoshtit për themelimin e komunës së Hogoshtit,
9. Njoftimi me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, z. Pieter Feith, për emërimin e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
10. Njoftim lidhur me tërheqjen e disa nënshkruesve të kërkesës për debat për gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës,
11. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e vizitës në Spanjë,
12. Njoftim i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e deputetëve – anëtarë të komisioneve parlamentare.

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 qershor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 qershor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me incidentin në Dhomën e Provave të Policisë së Kosovës të datës 25 prill 2009

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Raportin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministri për Punë të Brendshme që të përgatitë informatën për incidentin në Dhomën e Provave në Policinë e Kosovës të datës 25 prill 2009.
2. Informata e kërkuar sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi duhet t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne afatin sa më të shkurtër , për diskutim në seancën plenare, që është paraparë të mbahet më 25 qershor 2009.
3. **Shqyrtimi i propozimit për përbërjen dhe rindarjen e komisioneve parlamentare.**

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që t'i propozojnë kryesuesit, zëvendës kryesuesit dhe anëtarët e komisioneve parlamentare, sipas propozimit që është bashkangjitur si shtojcë e veçantë.
2. Propozimet duhen të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare më 11 qershor 2009.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave në KPM

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave të zyrtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, duhet t'i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Administratës Publike.

5. Shqyrtimi i kërkesës se deputetit Nexhat Daci për udhëtim zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, Nexhat Daci, për kompensimin e shpenzimeve për udhëtim zyrtar në SHBA, në mungesë të ftesës zyrtare, nuk miratohet.

6. Shqyrtimi i kërkesës se Grupit joformal të grave deputete për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar për pjesëmarrjen e kryetares së Grupit joformal të grave deputete, znj. Flora Brovina, në sesionin e VI të Punëtorisë Regjionale për gra parlamentare (GDF), që organizohet në Dubrovnik të Kroacisë, prej datës 14-16 qershor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

7. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projektligjit për KPMK- për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Grupit punues, në përbërje: Bahri Hyseni, Eshref Vishi dhe Hajredin Hyseni, në Maqedoni, prej datës 8 deri më 10 qershor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Iniciativës së qytetarëve të rrethinës së Hogoshtit, për themelimin e komunës së Hogoshtit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Udhëzohet Iniciativa e qytetarëve të rrethinës së Hogoshtit që t'i drejtohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me kërkesën e tyre.

9. Njoftimi me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, Piter Feith për emërimin e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kryetari e njoftoi Kryesinë lidhur me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, Piter Feith, për emërimin e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

10. Njoftim lidhur me tërheqjen e disa nënshkruesve të kërkesës për debat për gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës

Kryesia, pasi u njoftua me tërheqjen e disa nënshkruesve të kërkesës për debat, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia u njoftua lidhur me tërheqjen e disa nënshkruesve të kërkesës për debat për gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës.
2. Kryesia e Kuvendit kërkon nga Grupi Parlamentar i LDK-së, që t'i sigurojë nënshkrimet e deputetëve që i kanë tërhequr, në mënyrë që të evidentohen në sekretari.

11. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e vizitës në Spanjë.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Me qëllim të sqarimit të disa çështjeve lidhur me ftesën për vizitën zyrtare në Spanjë, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi, paraprakisht, do të bisedojë me kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian.

11. Njoftim i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e deputetëve – anëtarë të komisioneve parlamentare.

Kryetari e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se Grupi Parlamentar i LDK-së ka ndryshuar përbërjen e komisioneve parlamentare me këta deputetë.

Deputetja- Fatmire Berisha, emërohet anëtare e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në vend të z. Armend Zemaj, ndërsa deputeti Naser Osmani, emërohet zëvendëskryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe deputeti Armend Zemaj, emërohet anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**